



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:252074
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05636996

KPPP.nr.1915/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Durimi Sh.P.K., me seli në Vasilevë-Gllogoc, me NUI: 810254673, kundër debitorit Toifor Sh.P.K., me adresë në Prishtinë, Lagjja Emshir pn, me NUI: 810484890, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit P.nr.696/23 të datës 27.10.2023, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Gjokë Radi me seli të zyrës në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 29.04.2024, mori këtë:

AKTVENDIM

- I. APROVOHET ne tërësi i bazuar prapësimi i debitorit Toifor Sh.P.K., ashtu që SHFUQIZOHET Urdhri P.nr.696/23 i datës 27.10.2023, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat Gjokë Radi.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin P.nr.696/23 të datës 27.10.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave dhe atë: faturës nr.22-SHV01-001-216 të datës 31.10.2022, faturës nr.22-SHV01-001-275 të datës 30.10.2022, faturës nr.22-SHV01-001-297 të datës 15.12.2022, duke e obliguar debitorin që t'ia paguajë kreditorit obligimin në vlerë prej 10,833.00 Euro ta paguaj normën e interesit prej 8 % vjetore sipas vlerave të faturave dhe datave kur është dashur të paguhet borxhi, si dhe shpenzimet procedurale, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër Urdhrit të Përmbauesit Privat, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbauesit në tërësi si të pabazuar, për faktin se i njëjti ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbauese si dhe konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Më tej ka theksuar se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri, nuk paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbauesit siç është përcaktuar me nenin 21,29 par 1.1.3 dhe par.3 të LPP-së, për shkak se nuk janë të pranuar fare nga debitori, përkatësisht nuk janë të nënshkruara dhe të vulosura nga i njëjti. Po ashtu ka shtuar se urdhri është nxjerrë mbi bazën e faturave të cilat nuk kanë qenë origjinali por kopje të vërtetuara. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të anulohet në tërësi urdhri përmbauesit i Përmbauesit Privat, si dhe të obligohet kreditori që t'i paguajë të gjitha shpenzimet të cilat i janë krijuar pranë Përmbauesit Privat dhe shpenzimet e avokatit lidhur me përpilimin e këtij prapësimi të gjitha sipas tarifave në fuqi.

Kreditori, në përgjigje në prapësim, ka deklaruar se pretendimet e debitorit janë krejtësisht të pabazuara, për arsye se debitori asnjëherë nuk e ka kontestuar obligimin ndaj kreditorit. Më tej ka theksuar se fatura është lëshuar e rregullt konform procedurës së faturimit, në të cilën faturë është shënuar data e lëshimit dhe data e skadimit apo afati për përmbushje, me përshkrimin si në faturë, e cila i ka të gjitha elementet për titull ekzekutiv dhe ka tipare të përmbaueshëm sipas nenit 29 pika 3 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të obligohet debitori që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit të përmbush obligimin e tij ndaj kreditorit në vlerë prej 10,833.00 Euro, me normën e interesit prej 0.8% vjetore, si dhe shpenzimet procedurale të gjykatës.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbauese, (tutje LPP) dhe nenit 12 par.2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbauese, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbauesit duhet të anulohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbauesi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”* dhe me paragrafin 3 të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbauesit po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për*

përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit".

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarrim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Gjykata gjeti se fatura nr.22-SHV01-001-216 e datës 31.10.2022, fatura nr.22-SHV01-001-275 e datës 30.10.2022, dhe fatura nr.22-SHV01-001-297 e datës 15.12.2022, në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se faturat në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmbajnë nënshkrimin e as vulën e pranuesit– debitorit.

Duke qenë se debitori nuk i ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat e lartcekura, si të tilla nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme dhe nuk kanë tipare të përmbarrueshmëris, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar detyrimin që rrjedh nga faturat.

Gjykata vlerëson se meqenëse kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë nga e cila rezulton se pranimi i faturave konkrete është bërë në mënyrë të rregullt nga debitori, atëherë rezulton se faturat e lartcekura nuk mund të paraqesin bazë për lejimin e përmbarrimit.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1915/23 me datë 29.04.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.